Shënim hyrës

Në këtë dosje përfshihen artikuj të pakët , gjithsej 8, në katër gazeta dhenëperiudha të ndryshme që zenë gjithsej 20 faqe. Fjala është për gazetat: "Mapo", "Dita", "Panorama", "Pejasazhet e fjalës".
Me logjikën se kanë humbur me dhjetra artikuj të tjerë, ose gjetja e tyre në rrjet dhe nëpër arkiva gazetash është e gati e pamundur, ky pasqyrim ndoshta nuk ka vlerë. Por, shqyrtimi i tyre nga kendveshtrimi i thellësisë së mendimit, analizës, apo profilit të gazetarisë, kurajos civile e intelektuale në kohë të ndryshme, i bën atë të një rendësie të veçantë.

Εισαγωγή.
Στο συγκεκριμένο φάκελο συμπεριλαμβάνονται λίγα άρθρα, συνολικά 8, δημοσιευμένα σε 4 εφημερίδες, σε σύνολο σελίδων 20. Πρόκειται για τις εφημερίδες "Mapo", "Dita", "Panorama" και "Pejasazhet e fjalës".
Ξεκινώντας από την λογική ότι έχουν χαθεί δεκάδες άρθρα μου, ή η ανεύρεσή τους στο διαδίχτυο και στα αρχεία των ΜΜΕ είναι σχεδόν ανέφικτο, η προβολή τους δεν παρουσιάζει αξία. Όμως, η προσέγγισή τους με την οπτική γωνία του βάθους σκέψεις, ανάλυσης, ή ξεκινώντας από το δημογραφικό προφίλ, το κουράγιο πολίτη και διανοουμένου σε βάθος χρόνου αναβαθμίζει αυτά σε ιδιαίτερης σημασίας δημοσιεύματα.

PERMBAJTJA

MAPO

Antihelenizmi, leva ku mbështetet nacionalizmi i vjetër i politikës së re në Shqipëri.
19.11.2012 faq. 4

Miti i ri shqiptarocentrik si antihelenizëm: kremtimet për Pavarësinë dhe qasje për mitin e ri në Shqipërisë etnike
05.12.2012 /06.12. 2012 faq. 7

Retorika nacionaliste e Spahiut, një abuzim banal në emër të politikës së ditës.
13.04.2013/14.04.2013 faq. 10

DITA

Kumbullat hahen gjetkë, Shqipërisë dhe Greqisë i mpihen dhëmbët.
13.11.1994 faq. 14

S' janë vetëm të pestët që çuan në krizë.
12.02.1995 faq. 15

Ende kufizime për gjuhët e minoriteteve etnike
21.10.2001 faq. 16

Botim i PANORAMA GROUP

PANORAMA

Ngerç elektorial apo ngerçi i demokracisë?
01.01.2007/10/01/2007 faq. 17

PEIZAZHE TË FJALËS

Angazhimi i mangët intelektual në lidhje me marrëdhëniet greko-shqiptare në Epir shtrëmbërojnë historinë dhe vrasin të ardhmën.
07.02.2021 faq. 20

FUND faq. 22

MAPO

Antihelenizmi, leva ku mbështetet nacionalizmi i vjetër i politikës së re në Shqipëri.
19.11.2012

Miti i ri shqiptarocentrik si antihelenizëm: kremtimet për Pavarësinë dhe qasje për mitin e ri në Shqipërisë etnike
05.12.2012 /06.12. 2012

Retorika nacionaliste e Spahiut, një abuzim banal në emër të politikës së ditës.
13.04.2013/14.04.2013

Nga Panajot Barka

https://www.pressreader.com/
https://noa.al/lajmi/2012/11/253347.html

Antihelenizmi, leva ku mbështetet nacionalizmi i vjetër i politikës së re në Shqipëri.

19.11.2012

18 MAPO

OpEd

Opinione dhe Editoriale

01 02 03

Antihelenizmi, leva ku mbështetet nacionalizmi i vjetër i politikës së re

KOMENT

PANAJOT BARKA

Reagimet e skajshme të strukturave nacionaliste në vend me status të legjitimuar, për të dencuar "skandalin" e Ministrit të Punës, Spiro Ksera, në lidhje me takimin e tij "antishqiptar" me deputetin e Agimit të Artë K. Papa në Bularat me 28 tetor, është një bufonatë dhe pak me pak se një stuhi në gotë. Mëgjithatë, një fakti i tillë provon më së miri se këto struktura e ushqëjnë nacionalizmin e tyre me antihelenizëm. Që pasuesit e këtij lloji nacionlaizmi të kenë ushqim antihelen sa më të bollshëm, ideatorët e tij manipulojnë, strembërojnë dhe falsifikojnë çdo gjë që ka lidhje me Greqinë si antishqiptare. Tregon se synon hapur dhe në mënyrë provokative përkeqësimin e marrëdhënieve me Greqinë dhe krijimin e një situate paniku nacionalist tek minoriteti etnik grek në Shjqipëri. Synon të shkaktojë presion ndaj qeverisë në Tiranë, për të lëshuar terren frymës nacionaliste në përgjithësi e asaj antigreke në veçanti, në politikën e saj zyrtare të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë me Athinën, që përbën edhe garancinë më të mirë për rrugën e Shqipërisë drejt Evropës.

<u>Cila është e vërteta e takimit të Deputetit dhe Ministrit Spiro Ksera me deputetin K. Papa të Agimit të Artë</u>.

Takimi qe rastësor dhe mëse i zakonshëm në një ceremoni perkujtimore. U provua se të dy faktorët nuk e njihnin njeri tjetrin. Sapo mori vesh me kë bisedonte, deputeti grek u hodh në sulm duke i thenë z. Ksera, se je anëtar i një qeverie që nuk respekton të drejtat e "Vorioepirotëve". Dhe zoti Ksera iu përgjigj. "Unë jam këtu, jetoj dhe punoj këtu me familjen time dhe marr pjesë në qeveri për të mbrojtur të drejtat e minoritetit etnik grek. Nuk jetoj në Greqi dhe as vij këtu të hedh ndonjë shashkë e të kthehem prap në Greqi" Kjo ishte e tera, madje e pranuar në site-n e vet dhe nga Agimi i Artë. Pyetja shtrohet : -A ka qendrim më dinjitoz se ky nga një përfaqësues i minortetit grek, pjesëtar në parlament dhe në kabinetin qeverësës?!

Merita e politikanit të sotëm është të di t'i përgjigjet kujtdo me monedhën e tij dhe jo t'i kthej krahët, se kështu do partia "Kuq e zi". Diversioni i antihelenistëve nacionalistë shqiptarë, ngritur mbi gënjështrën, abuzimin dhe manipulimin sipas parimit të të bërit qimen tra, kthehet në shqetësim se amplifikohet me densitet kaq të madh sa që i ngjan dialogut final para një dyluftimi tragjik. Pjesëmarrja në këtë diversion antihelen e një pjese të sistemit medjatik, bashkë me mbeturinat e indokrinimit antihelen komunist, po e kthejnë atë në një pushtet informal, që mbyt çdo zë të arsyeshëm, mendjeftohtë, të civilizuar e me frymë Evropiane.

Problemi bëhet më i mbrehtë, po të kemi parasysht se në përgjithësi Ballkani rreshqet në kurthin e nacionalizmit, i cili jo rallë identifiokohet me faktorin shqiptar.
Po, ashtu nuk duhet harruar se situata e recesionit të zgjatur në Greqi e bën më të lehtë rrugëdaljen nacionaliste. Zgjedhjet e fundit politike në Greqi u dhanë akses zedhenësve të këtyre tendencave, pa ditur kush se si mund të administrohen në të ardhmën. Fakt është se, pas "arritjeve" të fundit të antihelenizmit të nacionalizmit shqiptar qeveria greke është nën presion për ta shtruar çeshtjen e nacionalizmit shqiptar në Bashkimin Evropian, e për te theksuar që Shqipëria, kanditja për në BE, nuk respekton parimin bazë për familjen Evropiane, atë të fqinjësisë së mirë. (!!!). Por qeveria greke duket se nuk ka ndërmend t'u dorëzohet këtyre sirenave dhe po këtë shëmbull duket se po ndjek edhe qeveria e vendit tonë.

<u>Për nacionalizmin antihelen shqiptar a është kjo strehë e fundit, apo dalje nga kjo strehë e fundit?!</u>

Mendoj se kemi të bëjmë fatkeqësisht me rastin e dytë. Madje, shihet qartë se zgjedhjet a ardhshme parlamentare do të kenë "patrioto-nacionalizmin"si sfondi kryesor me ushqim të përcaktuar,- antihelenizmin. Po ravijëzohen edhe konturet e forcave përbërëse të këtij "poli". Ai fillon me parti brenda kualicionit qeverisës dhe perfundon te kreu i opozitës. Kuptohet se formë të plotë ky pol ka për të marrë andej nga pranevera e vitit të ardhshëm, kur do të duket se cila nga partitë e mëdha do të ketë shansin për t'i fituar zgjedhjet e ardhshme. Kuptohet se implementimi në këto momente i një projekti të tillë, veçanërisht nga parti në kualicionin qeverisës, do të kërkonte largimin e tyre nga qeveria, që do të thotë se këto parti do të humbasin përdorimin e pushtetit për zgjerimin e elektoratit. Ideja e përfaqësuesve të këtij "poli" mbeshtetet tek fakti se populli është lodhur me politikën e deritashme "të demokracisë Evropiane dhe i ka kthyer asaj krahët. Oferta nacionaliste, ose politika patriotike,- mendojnë,- mund të ketë akses më të mirë tek votuesit e partisë më e madhe elektorale në që janë bojkotuesit e votimeve. Tri forca "AK-ja", PDIU-ja dhe LSI-ja kanë dalë në plan të parë të polit në strukturim. E pëlqyer duket kjo taktikë elektorale edhe për PS-në apo edhe ndonjë forcë tjetër politike, të re apo të vjetër, të vogël apo të madhe. (Lideri i PS-së mezi përmbahet kur i kërkohet të ulë tonet antihelene)
Qëndrimet e fundit të ministrit të Jashtëm Edmond Panariti në raport me Greqinë, tregojnë se, më shumë se përpjekje për kompromentim të kualicionit qeverisës, apo provokim të tij, është një kërkesë për të evidentuar më mirë rolin e liderit në këtë ndërmarrje, si forcë politike me e konsoliduar dhe me reputacion më bindës brenda dhe jasht vendit. (Zoti Panariti, pas vizitës në Greqi, i ndihmuar edhe nga zoti Meta, i amplifikoi deri ne dhjetëfish qendrimet e veta "në mbrojtje të shqiptarizmit" në vizitën e tij zyrtare në Athinë. Deklaratës në tone të bute të Ministrisë së jashtme Greke pas icidentit në Kelcyrë, shkaktuar nga pasues të "AK-së" dhe "PDIU-së", iu përgjigj nga posti zyrtar me deklaratë në mbrojtje të tyre, madje me të njëjtin fjalor. Pak ditë më vonë, në një emision televiziv foli për "Çeshtjen çame" me një terminologji që vuri në pozitë edhe kryetarin e partisë së çamëve. Me aktivistë të "AK-së" organizon seminare kualifikuese në strukturat e ministrisë së Jashtme – E mëgjithatë Ministri i Jashtëm Grek e merr në telefon zotin Panariti dhe i konfirmon pjesëmarrjen e tij në festime e 28 Nentorit në Tiranë).
Ajo që përbën një shqetësim tjetër është fakti se strukturat e këtyre forcave politike kanë në prapavijë një mbështetje ekonomike jashtë parametrave të çdo logjike. Burimi i tyre nuk dihet. Urojmë që të mos jenë, si zakonisht në raste të tilla, nga kanalet e parave të pista që aq zhurmshëm dëgjohen vite me radhë në Jug të vendit, e as nga shtete me interesa të caktuara në vendin tonë, e të shprehura ditë e fndit në shtypin e shkruar.

Po qeveria?

Eshtë tepër e vështirë që të besohet se qeveria dhe kryeministri nuk injohin dhe nuk i ndjekin këto zhvillime. Deri në një farë mase është e kuptueshme heshtja. Por, kryeministri, i cili i ka ndezur motorët e zgjedhjeve, por pa hapur letrat e tij, i ka kthyer sytë nga faktori ndërkombëtar. Ai e di shumë mirë dhe kushdo e kupton se nacionalizmi, aq me tëpër ndaj vendit të vetëm fqinj në BE, është një nocion dhe aksion i papërkrahshëm nga Perendimi. Po ashtu, mosdevijimi nga parimet që rregullojnë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me Greqinë, (pavarësisht nga qendrimet e Ministrit të Jashtëm, Panariti), i krijojnë kryeministrit mundësi reale që në zgjedhjet e ardhshme, të ketë totalisht me vete faktorin ndërkomëbëtar. FUND

Nga Panajot Barka

https://issuu.com/gazetamapo/docs/06.12.2012

Miti i ri shqiptarocentrik si antihelenizëm: kremtimet për Pavarësinë dhe qasje për mitin e ri në Shqipërisë etnike

05.12.2012 /06.12. 2012, faqe. 18

Kremtimet për Pavarësinë dhe qasje për mitin e ri të Shqipërisë etnike

Sa më shumë u largohemi diteve përmbyllëse të shekullit të parë të pavarësisë se Shqipërisë, aq më mirë dallohen anët pozitive dhe negative të kumteve "kremtuese"ë sa dhe si ditët e kësaj ngjarjeje të madhe u përdorën për qëllime të politikës së ditës, apo të aspiratës kombëtareë të frymës etnocentriste, apo evropianistikeë të patriotizmit, apo të nacionalizmit.

Në një pamje të përgjithshme u harxhuan energji të shumta për të plazmuar një mitologji të re me synim kryesor mbështetjen e ideologjisë së Shqipërisë etnike. Promotor i saj ishte politika e ditës, në shërbim të së cilës konsumoheshin edhe faktorë të tjerë. Politika u vu në garë, si për autorësinë, ashtu edhe për meritat më të shumta mit-formuese. Asetët që u përdorën janë të stërnjohura. Politikanët me një frymë romantike ekzaltuese përpiqeshin të glorifikonin dhe hyjnizonin çdo gjë historike në lidhje me pavarësinë dhe autorët e saj. Kjo nga njëra anë bëhej për të zmadhuar sado pak shtatin e tyre politik e patriotik dhe nga ana tjetër për t'i krijuar një pjedestal sa më të qëndrueshëm mitit të ri, pas të cilit mund të fshiheshin në rast se rrethanat do ta diktonin.

Praktika historike ka provuar se në kësi rastesh evidentohen dy korente qartësisht të dukshme. Nga njëra anë qëndrojnë ideologët dhe mjetet opinionformuese, që vihen në komunikim fymëzues të drejtpërdrejtë, dialektik me popullin. Korentin tjetër e përbëjnë instrumentat shtetërore e politike që e manaxhojnë produktet e korentit të parë sipas interesave shtetërore e kombëtare.

Në rastin tonë, këmbëngulja e politikës sfumoi çdo përpjekje të drejtimit të parë. Përfaqësuesit e këtij korenti, nën presionin glorifikues të ngjarjeve të Pavarësisë nga ana e politikës, u priren nga një objektivitet që synonte të thoshte se realiteti i para 100 viteve ishte më kombleks, më prozaik dhe jo aq i qartë. Se aktorët vendas të atyre ngjarjeve lëviznin sipas skemave të parabëra në kancelari evropiane, apo dhe të vetë Perandorisë Otomane në shembje. Pra, në ditët e "fabrikimit" të mitit të ri kishim një alternim rolesh me pasojë korenti i parë të mbesë jashtë kësaj ndërmarrjeje dhe të bëhej i padëshirueshëm nga politika. Rolin e tyre mitformues me kornizën e Shqipërisë etnike, e morën përsipër politikanët. Ky mit i ri, i veshur me një dekor të supërngarkuar "patriotik", servirej për konsum të brendshëm si aspiratë e mohuar, më shumë turmave të popullit, se sa shqiptarëve dhe shqiptarësisë, e që mbetej në kufinjtë e populizmit si aseti më efektiv në shërbim të politikës.

Politikanët partiakë mënjanuan edhe istrumentet apo institucionet shtetërore në manaxhimin e reagimeve nga kultivimi dhe zhvillimi i mitit të Shqipërisë etnike, ndërsa etnocentrizmi ktheu në bindje pothaj absolute se Shqipëria etnike do të bëhet të nësërmen, në ditën e parë të shekullit të ri të shtetit të pavarur shqiptar. Këta aktorë sillen kinse sikur nuk kuptojnë që në tavolinat e po të njejtave kancelarive që vendosen fatin e Shqipërisë para një shekulli apo dhe të shqiptarëve të Kosovës para një dekade e ca, nuk ka skema të reja në përputhje me aspirata dhe dëshira që shpreh miti i ri etnik. Politika e ditës në Tiranë bëri sikur se vuri re që rrethi i fqinjeve, por edhe kancelaritë e mëdha mbajtën frymën në lidhje me këto zhvillime dhe shigjetuan ashpër politikën zyrtare.

Nga ana tjetër, miti i ri i Shqipërisë etnike u shfaq me së shumti vlera mohuese e që konstatohet që në teprimet e skajshme, deri tek përpjekja për të afirmuar vetvetën në ballafaqim nacionalist me të tjerët. Ngjarja më dinjitoze e më afirmuese ishte koncerti festiv i dhenë në pallatin e kongreseve. Në këtë koncert njerëz të nderuar të afirmuar botërisht ose jo, me pjekuri kulturore e artistike mahnitese, folën me gjuhën e tyre të artit duke respektuar maksimalisht ditën historike dhe popullin shqiptar e duke treguar nivelin e aspiruar kulturor të një populli.

Mitologjia e re, zgjedhjet parlamentare, politika dhe kryeministri.

Platforma e Shqipërisë etnike u blatua kohë më parë në forume mendimi të lirë. Ajo u shndërrua në politikë nga disa parti të formuara rishtazi. Platforma e tyre edhe pse ngjante si dy pika uji me demagogjinë populiste,(që si thelb ka një aspiratë) fitonte terren elektoral. Intensifikimi i promovimit të "platformës"politike të Shqipërisë etnike në ditët festive të Pavarësisë, mori përmasat e një miti veprues si realitet. Aq e fortë qe kjo rymë saqë asaj nuk i rezistoi dot as Kryeministri i vendit, i cili tregohej shumë i kujdesshëm deri në ato çaste që deklarimet e karakterit etnik të mos kapërxenin cakun e lejueshëm patriotik. Madje me karizmën e tij të njohur u rembeu shumë shpejt inisiativën të gjithëve. Kthimi i kësaj teze në motivin qëndror të ligjerimit të tij politik, bëri që diferencimet ideologjike në spektrin e politikës shqiptare të pesojë shpejt një unifikim të karakterit etnik. (Nuk është se vetëm Berisha rembeu flamurin nacionalist. Rama gjithashtu, foli me bindje në Vlorë se pas disa viteve këtu do të ndodhin gjera që as mund t'i besojë sot njeri, si edhe rruga e flamurit kombëtar nuk ndalon këtu.)

Nga ana tjetër gjith ky ekspansion zbuloi edhe falsitetin mitit etnik. Këtë e vërteton fakti se sapo Berisha, artikuloi me forcën dhe patosin karakteristik të tij idenë e mitit etnik, flamurmbajtësit e deriatëhershëm të këtij miti, politikanë ose jo, për të fshehur panikun para vrullit të Berishës dolën me vrap për të thenë se "Mirë ne nuk mbajmë përgjegjesi për ato që themi (në lidhje me Shqipërinë etnike), por ai- Berisha ku vete. (?) Ai është kryeministër dhe nuk mund të jetë "aq i papërgjegjshëm" sa edhe ne (!!???). Gjë që tregon hapur se aspirata etnike është zenë robinë në kurthin e politikës së ditës dhe në këmbim të votës.

Momenti i dytë që terheq vemendjen në këtë rast është reagimi i mënjëhershëm i faktorit të jashtëm. Ideja e nacionalizmit dhe ligjerimi nacionalist kishte kohë që po fitonte peshë në opinionin publik shqiptar, por faktori ndërkombëtar thuajse nuk e vinte re. Por ai u zgjua mënjëherë sapo Berisha artikuloi një hartë të Shqipërisë së Madhe me vise historike, të cilat, për shkak të Perandorisë Otomane banoheshin edhe prej shqiptarësh. Kjo mesa duket lidhet, jo aq me postin kryeministror të Sali Berishës, se sa me faktin e peshës dhe rolit të tij në politikën shqiptare. E çuditshme është se reagimet nuk vijnë vetëm prej faktorit të jashtëm, por ligjerimi nacionalist i Berishës u konsiderua i demshëm dha nga vet ithtarët e nacionalizmit të ri shqiptar. (!!!)

Një moment tjetër, të cilin duhet ta permendim për disa arsye, lidhet me faktin se reagimi i Perendimit (apo edhe i Lindjes), ndaj deklaratave të Berishës, filloi dhe u intensifikua mënjëherë pas reagimit të Athinës zyrtare. Do të ishte e tëpërt të flisnim këtu për peshën e fjalës së Athinës në arenën ndërkombëtare, gjë që më shumë se kushdo e njeh Sali Berisha. Por, fakti që Berisha e ngjeu artikulimin e tij "nacionalist" me antihelenizmin e nacionalizmit shqiptar, tregon se ai e kuptonte se për të qenë bindës në ligjerimin nacionalist shqiptar, duhej me një farë mënyre të promovohej edhe si antihelen.

Nga ana tjetër fakti që Athina zyrtare, pa si dorashkë të hedhur ndaj vetës deklaratën e Berishës tregon se as qeveria greke nuk ishte në gjendje që t'i rezistonte presionit nacionalist në Greqi, dhe se tanimë rreshqitjet nacionaliste po kthehen në shqetësim shumë të madhë. Por këtu qëndron edhe gabimi i qeverisë greke. Duke

reaguar posaçerisht ndaj deklaratës së Berishë identifikoi antihelenizmin e nacionalizmit shqiptar me e njeriut që në fakt tregon një korrektësi dhe luajalitet në bashkëpunimin dypalësh.

Kursesi, nuk mund të vendoset një lidhje midis deklaratës së Berishës, e cila në një rast tjetër as që do të vihej re, me ngritjen provokative të flamurit shqiptar në Akropol. Por ka një lidhje midis nacionalizmit shqiptar të artikuluar si antihelenizëm. Kjo vështirëson së tëpërmi çdo përpjekje në Athinë për të zvogëluar efektin e deklaratës së Berishës qoftë edhe me argumentin bindës se u bë në kuadrin e fushatës elektorale. Vështirësia nga njera anë qëndron tek fakti se streha nacionaliste ofrohet bujarisht edhe për globalistët e skajshëm në Greqi, por edhe pse nacionalizmi shqiptar, madje nga aletatë qeverësisë, ushqehet me deklarata dhe qëndrime që provokojnë reagime.

Kjo do të thotë se pa kuptuar, situata e brendshme në vend por edhe në raport me Greqinë apo me fqinjët e tjerë, po merr trajta radikale dhe do të qe ngushëlluese sikur kufiri final të identifikohej me datën e zgjedhjeve.

Nga ana tjetër, duke qenë një situatë e tillë, është mese e sigurt që ditët në vijim do të provojnë se e gjithë kjo do të kthehet në një kurth që po i ngrihet edhe aspiratës etnike, në emër të politikës së ditës.

Panajot Barka 05.12.2012

Nga Dr. Panajot Barka.

https://gazetamapo.al/retorika-nacionaliste-e-spahiut-nje-abuzim-banal-ne-emer-te-politikes-se-dites/

http://www.mapo.al/2013/02/retorika-nacionaliste-e-spahiut-nje-abuzim-banal-ne-emer-te-politikes-se-dites/comment-page-1

Retorika nacionaliste e Spahiut, një abuzim banal në emër të politikës së ditës.

13.04.2013/14.04.2013

MAPO 11

Retorika nacionaliste e Spahiut, një abuzim banal në emër të politikës së ditës

KOMENT

PANAJOT BARKA

Kë fyejti Kreshnik Spahiu me fjalorin e vet horror për ushtarët grekë të renë në tokën shqiptare në luftën italo-greke? Kuptohet, nuk mund të fyhen ata që korrën fitoren e parë të popujve europianë mbi makinën fashiste, ata për të cilët Churchill-i i madh ka thënë se "që këtej e tutje do të themi se heronjtë luftojnë si grekë". Nuk mund të fyhen as ato dhjetra familje shqiptare, fshatra e komuna që i respektuan dhe i ruajtën varret e tyre për dhjetra vite. Kreshnik Spahiu, ka fyer veç veten, pasi dhunoi barbarisht një nga vlerat njerëzore nga më të lashtat dhe më humanet, respektin për të vdekurin, vlerë që për popullin shqiptar është më sublime.

Në kohështrirjen midis betejave në luftën italo-greke batalioni i prapavijës së ushtrisë italiane varosi përkrahë varrëzave të ushtarëve të tyre në tokën shqiptare 6 300 ushtarë grekë, duke vendosur përmbi to mbishkrimin. "Armiq në ngjallje, miq në vdekje". Urojmë që qëndrimi i Spahiut të përbëjë thjesht shthurjen morale të tij dhe aspak të ideve që ai përfaqëson.

Por cila është arsyeja që logjika e Kreshnik Spahiut kapërceu tej humanizmit fontamental?! Një përgjigje sempliste thotë se Spahiu provokon që t'i japin rendësi, me qëllim që ai të fitojë të drejtën për të ridalë "në fushën e betejës", qoftë edhe si Don Kishot. Por ai injorohet në këtë përpjekje të tij gjë që e detyron të kapërxejë .... (E vërtetoi këtë vet kur komentoi heshtjen e kryeministrit ndaj sulmeve të tij ekstremisht të palëjueshme). E vërteta është se ndikon ndjeshëm në forcimin e krahut nacionalist në Greqi, ashtu siç është fakt se Spahiu i shmanget ballafaqimit me të, pasi ka frikë se zbulohet falsitetit i nacionalizmit të tij.

Pyetja e dytë që shtrohet thotë se përse retorika nacionaliste e Spahiut dhe në përgjithësi në vend, merr gjithnjë e me shumë trajtën e antihelenizmit ekstrem deri në absurditete të mësipërme?

Ne Greqinë e lashtë filozofët për të vlerësuar mendimin e tyre (të pakicës) e ballafaqonin atë me mendimin e të tjerëve, (të shumicës). Kjo mënyrë vlerësimi u konsiderua si shkolla e parë e studimit të mendimit dhe kulturës analoge. Në antropologjinë sociologjike kjo kategori mori formën "ne" dhe "të tjerët" dhe u përdorë si formulë efikase për të siguruar unitetin e brendshëm të një komuniteti të caktuar, sidomos në aspektin etnik (ne) në ballafaqim me një grupim tjetër kundërshtar, armik, pushtues (të tjerët). Gjatë formimit të shtetëve kombe në Ballkan, shek XIX-XX, formula "ne" në ballafaqim me "të tjerët" justifikoi në një masë të madhe sakrificat e popujve të rajonit për realizimin e aspiratave të tyre. Të njëjtën formulë, por me

përshkallëzim ekstrem e rimori ideologjia komuniste në Shqipëri për të siguruar "unitetin e brendshëm" në sistemin e vet social –nacionalist. Greqia u përcaktua si një nga përbërësit kryesorë të grupimit "të tjerët", trajtuar si armiku me pretendime aneksoniste. Përpjekja u shoqërua me mbartje dhe remineshenca të periudhës shtetëformuese dhe u shndërruan në një mentalitet-steriotip. Spahiu kërkon pikërisht instrumentalizimin në kushtet e sotme të këtij mentaliteti duke gjeneruar steriotipin.

Në këtë përpjekje nuk mund të mos vihet re se Aleanca Kuq e zi nuk mund të shpalos vlera afirmuese të nacionalizmit Shqiptar, që do ta karakterizonin atë si lëvizje patriotike, pra si nacionalizëm patriotik. Spahiu e ka ngritur ideologjinë e tij nacionaliste më së paku si antihelenizëm. Në këtë kendveshtrim vlerat patriotike që ai kultivon shfaqen si urrejtje ndaj të tjerëve, ose më së paku si ksenofobi e rremë, gjë që aktualisht i ka shkaktuar probleme imazhit të vendit në Evropë dhe në arenën më të gjerë ndërkombëtare. Më e keqja është se aksioni i tij veprues ngrihet mbi mbartjet e fragmentarizuara, të deformuara dhe të stërmadhuara nga e kaluara. Më mënyrën e të thenit e të stërthenit, Spahiu dhe pasuesit e tij përpiqen të krijonë bindje për të vërteta të paverifikueshme, si vijim i mentalitetit –steriotip komunist. Kjo nga njera anë mban të traumatizuar ndërgjegjen kombëtare me episode që në historinë shekullore midis dy popujve nuk kanë as rendësinë më të vogël. Nga ana tjetër i sjellë dem të pariparueshëm për ekulibrat e brendshme. Nuk dua të flas këtu për ndjesitë dhe pozitën e pengut në të cilën është venë minoriteti etnik grek nga ky lloj nacionalizëm antihelen.

Por, nuk mund të mos vihet re pozita e fajit në të cilin është venë komuniteti ortodoks në Shqipëri. Spahiu, duke mbartur mentalitetin ateist të komunizmit në funksion të forcimit të kombëtarizmit socialist, mori peng të nacionalizmit të tij antihelen, komunitetin ortodoks. (Asnjë komunitet fetar në botë nuk do të toleronte sulme të kësaj natyre nga njerëz politikë dhe apolitikë me përkatësi fetare të tjera. Heshtja e venë re në komunitetin ortodoks, në se nuk është tolerancë fetare nga mungesë besimi, gjë që ka pak gjasa, është gërryerje në tolerancën e grehinës etnike.) Dhe kjo është e pafalshme, po të kemi parasysh se bëhet për qëllime imediate të politikës së ditës, për një grusht votash.

Por perse Kreshnik Spahiu e rrit përditë dozën nacionaliste të ligjerimit të tij "politik" në një kohë kur shqetësimi i faktorit ndërkombëtar e shikon retorikën nacionaliste si nder elementët bazikë që mund të ndikojnë negativisht në mbarrëvajtjen e zgjedhjeve!?

Mendoj se dy janë arsyet kryesore. Së pari Kreshnik Spahiu kërkon të peshkoj vota. Nacionalizmi i tij i parashtruar si abuzim me aspiratën kombëtare shqiptare dhe si antihelenzëm, kërkon të josh me pjesëmarrje në votime në favor të grupimit politik që ai përfaqëson të votuesve shqiptarë që i kanë kthyer krahët politikës sociale në vend.

Por qëllimi kryesor i nacionalizmit antihelen është të dobësojnë pozitat e forta të Kryeministrit Sali Berisha. Dihet që pragmatizmi politik i Sali Berishës e ka bërë atë të njohë dhe të respektojë rolin e Greqisë si fuqi Evropiane në Ballkan e në Shqipëri. Për pasojë ai ka ruajtur me Greqinë marrëdhënie tëpër korrekte dhe bashkëpunuese, në atë sens që janë në interes të të dy vendeve, por në aspektin relativ me shumë në interes të Shqipërisë si një vend që i duhet hapja, zhvillimi, integrimi.

Duke instrumentalizuar antihelenizmin si një sensibilitet patriotik shqiptar, tentohet që çdo qendrim korrekt i qeverisë aktuale me Greqinë të identifikohet me tradhëti kombëtare, me prapamendimin që ajo të kundërvotohet nga votuesi shqiptar.

Në të njëjtin qëllim çon nga ana tjetër diversioni i Kreshnik Spahiut në Minoritetin etnik Grek. Ai dhe mjetet apo instrumentet prapa tij sulmojnë në mënyrë të paskrupull, për "marrëdhënie me nacionalizmin ekstrem grek", njerëz nga minoriteti etnik grek pranë qeverisë dhe mazhorancës. Në fakt objektivi i vërtetë nuk janë ata por

kryeministri, pasi tentohet serish të krijohet nga një drejtim tjetër, "marrëdhëniet tradhëtare" të tij me armikun helen. Një arsyetim i thjeshtë do të kërkonte që ai duhet të manifestonte antihelenizmin e tij në strukturat përfaqësuese zyrtare të minoritetit etnik grek. Por çuditerisht ai ka përzëmër përfaqësues të këtij minoriteti në mazhortancë.

Dhe për të argumentuar me bindshëm këtë kongluzion theksojmë se sapo u vu re që PBDNj-shi tregoi se nuk do të vazhdojë të jetë aleate me PS-në, aleaten udhëheqëse të Aleancës Kuqezi, Spahiu iu sul (por ama politikisht) edhe kryetarit të kësaj force me "akuzën" se shkon majtas djathtas "për krijimin e kualicioneve tradhëtare" (!!) Po ashtu, aderimi në aleanca politike të kundërta ka çuar në distancimin me kohë të Spahiut me PDIU-n, edhe pse shpalosin të njëjtën platformë nacionaliste.

Si kongluzion final duhet thenë së nacionalizmi i Kreshnik Spahiut dhe pasuesve të tij ka vetëm një qëllim t'i shërbejë politikës së ditës, të peshkojë disa vota dhe asgjë më shumë. Këtë argument nuk e vërteton vetëm analiza e mësipërme, por edhe aksioni i tij i deritanishëm nacionalist që midis deklarimeve dhe realitetit qendrojnë lëvizjet bosh.

13.04.2013 (për Gazetën MAPO) U botua te nesermen faqe 10

DITA

PERMBAJTJA

Kumbullat hahen gjetkë, Shqipërisë dhe Greqisë i mpihen dhëmbët.
13.11.1994 faq.

S' janë vetëm të pestët që çuan në krizë.
12.02.1995 faq.

Ende kufizime për gjuhët e minoriteteve etnike
21.10.2001 faq.

Intervistë me "disidentin" e OMONIAS Panajot Barka

Kumbullat hahen gjetkë, Shqipërisë dhe Greqisë i mpihen dhëmbët



Për fillim të bisedë: Sa përqind e ndjeni veten grek dhe sa shqiptar,sa politikan dhe sa gazetar?

Bukur, e nisët me "aritmetikë". Shiko, unë jam një nënshtetas i mirë i shteti tim, por djalit tim i flas dhe i këndoj greqisht. Jam shqiptar aq sa është grek ambienti në të cilin komunikoj, dhe mendoj se kjo është formula magjike e relatave shoqërore dhe e bashkëjetesës në këto troje para dhe pas shpikjes, apo vendosjes së kufijve. Për pjesën tjetër të pyetjes, dua të them se gazetaria është dashuria ime profesionale dhe politikën e shoh nga ky prizëm, ndaj dhe s'di të heshtë, të kem një vend brenda shpirtit që të fsheh gënjeshtrën, të grumbulloj pisllìqet, etj, gjëra të profesionalizmit në politikë.

Mbas përfaqësimit që i bëtë OMONIA-s në Kuvendin Popullor, rezultat i përjashtuar nga kjo organizatë, ndërkaq që vetë ajo u përjashtua si subjekt elektoral. Ishit ju që nuk u pajtuat me politikën e OMONIA-s, apo ishte ajo që kishte rezerva ndaj ish-deputetit Barka?

OMONIA nuk i shpëtoi dot asaj sëmundjeje të "foshnjërisë" së krijesave politike shqiptare, aq më tepër që ne, krijuesit e saj e kishim konceptuar si front OMONIA-n, pa menduar shumë për të rregulluar me sistemet bashkëjetesën e të kundërtave brenda saj që e ngritëm në këmbë e i dhamë emër, jemi viktima të krijesës sonë. Kjo është tragjike, dhe jo aq për ne se sa për vetë krijesën tonë, se shënon fundin e saj. Kjo vlen edhe për krijesa të tjera të natyrës politike në Shqipëri, dhe këtu e ka bazën "pjelshmëria" e madhe e partive në shoqërinë tonë.

Sipas jush, cila pikëpamje, cili shkak qëndron në thelb të këtij divorci dhe nga kush u mbështetën iniciativat tuaja?

Cili është shkaku i divorcit? Hëm...Shiko! Është vështirë të përmblidhet, por megjithatë them dicka, që prapë mendoj se është tipike për politikën shqiptare. Shndërrimi i udhëheqjes së OMONIA-s dhe i mendimit të saj në një bisht të të tjerëve. Këtë si proces do ta quaja "kukullzim" (shndërrim në kukull) të udhëheqjes. Ju kujtohet për shembull me ç'shpejtësi precipituan ngjarjet në nëntor dhjetor 1991? E pra, unë këtë e lidh me kthimin e dr. Berishës nga ShBA.

Nga deputetët minoritarë në shumë legjislatura spikatin dy: shoqja Vitori Çurri e ulur në karrigen e nenkryetares, babaxhane e nie një buzëqeshje përherë miratuese, dhe z. Panajot Barka përherë i vrejtur dhe gjithmonë kryeneç. Ç'kanë të përbashkët dhe çfarë i dallon këto dy figura?

Ky është mendimi juaj. Unë nuk e kam parë kurrë pozicionin tim në interesa të tilla. Megjithatë, do të thoja se na bashkojnë fjalët "deputet dhe kuvend" si dhe të qënit minoritarë grekë. Unë e respektoj zonjën Çurri se është nga të parat që ftoi intelektualët minoritarë për t'u hapur dyert e pushtetit të atëhershëm për probleme të mprehta të minoritetit, është e para që e pranoi OMONIA-n, u anëtarësua në të dhe nuk kërkoi pjesë në udhëheqje si disa të tjerë që iu bënë gurë në qafë OMONIa-s. Por OMONIA e braktisi atë si shumë figura të tjera me vlera, përvojë, kulturë e aftësi. E braktisi në fatkeqësine e saj më të madhe, në vdekjen misterioze të djalit 30-vjeçar. Është pikërisht një fenomen i tillë, braktisja dhe mohimi i vlerave, sidomos njerëzore, të krijuara në gjysëm shekull vërtet të zi që krijoi një boshllëk, një gërryerje të pandreqshme në shoqërinë shqiptare dhe aq më keq në komunitetin tonë.

Cilat janë sipas jush problemet që i parashtrohen sot minoritetit grek, ku ndryshojnë ato në kushtet e pluralizmit dhe demokracisë nga ato të periudhës së diktaturës komuniste?

Problemet janë të njëjta, por tani shtohet edhe një mosbesimi i pushtetit ndaj grekëve të Shqipërisë, që t'iu ofrojë poste drejtuese në strukturat e tij. Kjo e pengon atë për një integrim të natyrshëm në shoqërinë shqiptare. Një qëndrim i tillë, bashkë me mungesën e aplikimit në praktikë të të drejtave të tjera, të identitetit kombëtar, prodhon tendenca izolacioniste ndaj shoqërisë shqiptare dhe ushqen nacionalizmin. Dhe as që guxonim të mendonim dicka më shumë se pikatorja e "mëmës parti", sot veshtirë t'i fitosh të drejtat [illegible] *nga asnjë organizatë, por nga pluriformat politike, e nuk kanë një mbivendosje programash?*

E saktë, madje ka edhe mbivendosje edhe në njerëz në udhëheqjet respektive. Por vetëm kaq, se veprimtaria praktike e tyre dhe ndikimi në politikën shqiptare është mjerisht i pandjeshëm, në një kohë kur të drejtat e njeriut përbëjnë "thembrën akiliane" për shëndetin e derisotshëm shqiptar. Do të shtoj akoma, se një mbivendosje e tillë çoi edhe në erozionin e brendshëm tek çdo formacion politik. Është dicka e pasqaruar edhe tek ata që i udhëheqin këto forume. Mos harroni "bishtin" që ju thashë, PBDNj ishte emergjencë e të pastrehuarit, por ustallarët harruan të mendojnë për rregullime të mëvonshme.

A ka zhgënjim në opinionin minoritar për politikën e ndjekur nga Greqia ndaj Shqipërisë?

Nuk e di nëse e keni fjalën për politikën e qeverisë së Greqisë ndaj minoritetit grek në kuadrin e shtetit shqiptar...?

Jo në një kuadër ndoshta më të gjerë...

E kuptova, atë që konstatoj, ashtu si dhe ju ndoshta, është se grekët, qytetarët dhe shteti janë të pakënaqur nga qëndrimi mosmirënjohës i Tiranës ndaj Greqisë. Ka qytetarë grekë, dhe s'janë pak, që kundërshtojnë politikën aktuale të Athinës ndaj Shqipërisë, ashtu siç ka forca politike greke që e shikojnë qëndrimin e Tiranës si përpjekje për të eksportuar problemet e brendshme, ose për t'u shërbyer të tretëve në bazë të parimit "armiku i mikut tim është..."

E kam fjalën në planin e Shqipërisë...

E njëjta gjë ndodh, ndoshta më një tendosje të brendshme më të madhe, por të heshtur ndaj Tiranës. Dëshiroj të theksoj këtu dicka: Askush nuk e shet identitetin e vet për të jetuar më mirë. Identiteti kombëtar nuk është mall, kështu që gënjehet ai që e mendon se e blen, por mjerë për atë shtet që mendon të ndaloje shtetasit e vet të shesin identitetin kombëtar për një copë buke. Ky është fundi i tij.

I i lashë të shpreheshit për këtë çështje pasi edhe kjo më interesonte. Gjithsesi kur përmenda "zhgënjimin" e kisha fjalën për minoritarët, për politikën greke të bllokimit të kufijve, të kredive dhe të pasurive...

Kuptohet që po. Greqia bën lëvizje në emër të të drejtave të minoritetit, por këto veprime e masa s'janë të kuptueshme për minoritetin, janë pa produktivitet, veçojmë në braktisjen e tij, në një klimë të ftohtë nga të gjitha anët rreth tij.

Si e vlerësoni gjyqin ndaj "të pestëve"? Viktima apo faktorë?

Si një proces që i shërben një situate të tensionuar. Në këtë aspekt ata janë viktima, apo personazh pa emër në këtë cusus beli mes Tiranës dhe Athinës. E vërteta është se kumbullat nuk i ha as Tirana, as Athina. Kumbullat më sa duket hahen gjetkë, dhe Greqisë, Shqipërisë [illegible] Ballkani do të vijë gjatë [illegible] gjeostrategjike me [illegible] Kjo për ata kohë sa vendet e tij s'do të gjejnë mirëkuptim dhe kryeqytet e tij do shikojnë ca drejt Evropës, ca drejt Amerikës, ca drejt Azisë...

Flisnim vetëm për "të pestë"...

...dhe unë them se më vjen keq, por kurrsesi nuk dua, ashtu sikurse nuk besoj se është "fajësia" e tyre shtak i vuajtjes në popull të pasojave të akullta ndërshtetërore. Madje, as "të pestët" nuk do të pranonin një sakrificë të popujve në këmbim të lirisë së tyre.

Cili është qëndrimi juaj për politikën ultranacionaliste të "Vorio Epirit", a pajtoheni me pikëpamjen e z.Ceka që "Ai politikën që spekullon me autoktoninë është qen bir qeni"?

(Rudh buzët) Më falni, nuk do ta pranoja termin "politikë ultranacionaliste Vorio Epirote". Është nuazuar nga fjalori politik i mbarsur me nacionalizëm.

Në vend të një përgjigje direkte e do të preferoja të nënvizoja se duhet të ruhemi nga fantazmat nacionaliste të së kaluarës. Ata janë më shumë pjellë e krizave politike, ekonomike dhe ideve të kohës që jetojmë, se sa e inferioriteteve apo avantazheve të një kombi të caktuar, të kufijve mes lumenjsh gjaku. Që të mos bëm viktima, që të shpëtojmë gjumin nga këto fantazma mendoj se popuj duhet t'u shmangen boshllëqeve të politikës. Ata kanë kodin e tyre të veçantë, të mirëkuptimit, [illegible] fqinjësisë, bashkëzisteneës etj.

Është interesant ky kod. Ka një kënge të moçme në minoritet. Në tekstin greqisht të saj refreni ka katër fjalë domethënëse në shqip. Më interesante me subjektin tragjik të këngës është fshehja e autorit të vrasjes së një të riu, sigurisht kjo brenda kodit të ruajtjes së bashkëjetesës midis palëve me etnitet të ndryshëm.

Sot në trevat e Jugut, veçanërisht në qytete, përzierjet etnike e fetare pa asnjë trazim shqetësues janë aq shumë sa që pothuaj çdo familje të kujton një Sarajevë të vogël. Merret me mend çdo të ndodhte po të guxonim të prishnim këtë harmoni. Popujt mes tyre japin e marrin, saqë edhe ndonjë grindje e rastësishme ngjan si një zërkë midis vëllezërish. Shumë qartë mund të dallosh se edhe në qelizën e shoqërisë në familje marrëdhëniet janë ndërtuar mbi bazën e bashkëjetesës dhe mirëkuptimit ndëretnik. Vetëm politikanët shikojnë interesin. Dikur na kanë vënë kufij që të zihemi herë pas here dhe me sa duket dikush sot na imponon të jetojmë me psikologjinë e një parandeshjeje...

Mos vallë këto pohime tradhëtojnë idealet tuaja, apo tentojnë shmangien e etiketimit të dikurshëm për ju, "nacionalist..."?

Jo, aspak. Etiketuesit kanë ngatërruar një mbrojtës të të drejtave të minoritetit, ndoshta shpërthyes, me nacionalistin. Megjithatë unë i falë të gjithë. Edhe nalën fjetër që më aktuzon si tradhëtar.

Si është i angazhuar sot mendimi intelektual në zgjidhjen e problemeve që ka minoriteti?

Nevoja për të jetuar, klima jo e favorshme brendaq në OMONIA dhe përgjithësisht klima politike në Shqipëri, janë disa nga shkaqet që vërtet e mbajnë larg problemeve aktuale mendimin e mirëfilltë intelektual të minoritetit grek, por jam i bindur se shumë shpejt do të kemi një kthesë.

Çfarë pozicioni rekomandoni për minoritetin dhe subjektet e tij politike; bashkëpunim me Tiranën dhe konsultim me Athinën, apo bashkëpunim me Athinën dhe konsultim me Tiranën?

Jo, i rekomandoj respektin dhe zbatimin rigoroz të ligjshmërisë së shtetit shqiptar, bashkëpunim me Athinën dhe konsultim me Tiranën dhe Athinën për frytshmërinë e bashkëpunimit.

Një "autonomi" e pështpërirë sa është e mbështetur në dokumente ndërkombëtare, kush do përfitonte më shumë prej saj: minoriteti apo Greqia?

E përcaktoni saktë "e pështpëritur" pasi erdhi si pasojë e të qenit "bisht" i të tjerëve që jetojnë për kohën e shkuar e jo për të ardhmen. Nuk e mohoj se, zëra e jo pështpëritje mund të ketë vazhdimisht, bile mund të shtohen po të vazhdohet me shkelje të të drejtave, e mund të shkohet më tej po të prishet statusKuoja se në brishtësinë e ekulibrave nacionale të Ballkanit dhe në kushtet e kalimit nga kolha e luftës së ftohtë në atë të paqes së nxehtë, çdo gjë është relative dhe ndonjëherë jashtë dëshirës së popujve. Përsa i përket dokumenteve ndërkombëtare ato kanë vend për çdo gjë që rregullon mirë standartet e të drejtave të njeriut. Ndërsa pas çdo forme të re politike duhet të fitojnë të gjithë ata që kanë lidhje me objektin.

Ç'pasoja rëndojnë mbi minoritetin në kushtet e ngrirjes së marrëdhënieve Shqipëri-Greqi?

Pasoja të shumta. E para, se ngrirjen në fillim dhe me shumë e ndjejnë pjesët e skajshme të trupit. Pastaj minoriteti ka një përvojë të gjatë 50-vjeçare marrëdhëniesh të mpira. Nga ana tjetër, këto tre-katër vitet e fundit shumë probleme që lidhen me arsimin, shëndetin dhe ekonominë, minoriteti ashtu si i gjithë Jugu i ka të lidhura me Greqinë.

Po perspektivën si e parashikoni?

Besoj se vullneti politik do t'i bindet atij të popullit.

Çfarë roli mund të luaj minoriteti në këto kushte për normalizimin e shpejtë të marrëdhënieve?

Minoriteti duhet të ruhet nga fantazma, të ruaj ekulibrat dhe të mos bëhet pre e skenarëve të rrezikshëm. Ky është sherbimi i madh i tij për mbrothësinë e marrëdhënieve shqiptaro-greke. Nuk dua ta fsheh, kam një parandjenjë jo të mire se minoriteti grek i ngjan lëkurës së qenit që e tendosin shumë duar për ta vendosur të dej dhe të gjithë i bien, jo për ta provuar kumbimin, por dikush për "ta mbrojtur", dikush për ta rrjepur, dikush për ta sjellë në rrugë "të mbarë"...

Si e vlerësoni rolin që përpiqet të luaj OMONIA për ndërmjetësim?

P.Barka- Si një përpjekje të dështuar pa u nisur. Dyshoj se po i hap punë vetes. Po e shtjelloj më tej mendimin. Kjo lëvizje për Athinën ishte lëvizje potokolli nga njëra anë dhe nga ana tjetër përpjekje për t'i rritur kredibilitetin udhëheqjes së OMONIA-s, të drobitur keqas kohët e fundit. Propozimi i Qirjazatit u dëgjua në Athinë, por pa asnjë predispozitë për të ndikuar në vendimet e Qeverisë greke. Për Tiranën kjo lëvizje vlerësohet sipas moralit të proverbit: "Ne s'të qasim në fshat, t'i kërkon për nuse vajzën e priftit".

Dukeni pak i ashpër kur flisni për Qirjazatin...

Jo,se veprimet e Qirjazatit me shokë kohët e fundit s'kanë autorizimin e askujt, janë të pastudiuara, kontradiktore dhe shpesh në dëm të minoritetit.

Më duhet t'ju pyes së fundi, ambicja juaj ku synon, në politikë, apo gazetari?

Për mua gazetaria është si dashuria e fshehtë, për të cilën nuk dëshiron të pëfundojë shpejt në rutinën martesore, ndërsa politika si një grua që i futesh në krevat me mblesën për emër apo pasuri. Megjithatë vazhdoj të jem në shërbim të njerëzve që aq shumë i dua, me mënyrën që ata duan.

Intervistoi:
ENGJËLL SERJANI

DITA
...informacion
Viti i tretë i botimit Nr. 154 E diele 12 shkurt 1995 Çmimi 10 lekë E PAVARUR

Eksperienca tregon se partitë ...deformohen dalëngadalë. Duhen forca intelektuale e mendore për korrigjimin e tyre

REXHEP QOSJA

Interviste me Panajot Barken

S'jane vetem te pestet qe çuan ne krize

"Dita": Cili është mendimi juaj për lirimin me kusht të katër veprimtarëve të OMONIA-s prej Gjykatës së Kasacionit?

P.Barka: Mendoj se është një pyetje që rrjedh nga vetë rëndësia e vendimit të marrë nga Brozi. Brozi në atë moment, besoj se nuk kishte të bënte vetëm me drejtësinë. Edhe vetë çështja që gjykonte nuk ishte e thjeshtë. Ajo indirekt lidhej me çështje shumë të rëndësishme të politikës së brendëshme shqiptare dhe akoma më tepër me marrëdhëniet shqiptaro-greke. Brozi bëri atë që ishte më e mundshme për t'u bërë në realitetin shqiptar. Ai zbatoi drejtësinë si një gjykatës dhe nga ana tjetër u shfaq edhe si një politikan i mirë. Megjithatë nuk mund të them se drejtësia shqiptare ka fituar pavarësinë e saj. E kam fjalën këtu për vonesat në zbatimin e vendimit, telefonat në orët e fundit për Brozin.

"Dita": A do të ndikojë ky vendim në përmirësimin real të marrëdhënieve midis këtyre dy vendeve apo mendoni se shkaqet e vërteta të acarimit janë më të thella?

P.Barka: Për momentin që po flasim padyshim që do të ketë përmirësime të dukshme në marrëdhëniet ndërshtetërore ose më sakt midis dy qeverive. Pasi marrëdhëniet mes popujve edhe në çastet e acarimit para gjyqit ishin të mira. Pra vendimi i Brozit do të ndihmojë vetëm qeveritë për t'u mirëkuptuar. Pala greke menjëherë manifestoi gatishmërinë e saj. Vetë Papulias tregoi një gatishmëri të jashtëzakonshme, pavarësisht se zëdhënësi Venizellos ishte më i përmbajtur. Nuk e kuptoi pse Tirana në këto momente heziton të tregohet e hapur ndaj deklaratave të Papulias. Për sa i takon pjesë së dytë të pyetjes do të thosha se është shqetësuese dyshimi që shpreh pyetja pasi për mua marrëdhëniet, edhe drejtësia, edhe demokracia nuk duhen parë jashtë problematikës ballkanike. Kështu mendoj se nuk është vetëm çështja e të pestëve që i çoi marrëdhëniet në krizë. Eshtë kriza e rajonit që reflekton herë pas here kriza në marrëdhëniet dypalëshe. Eshtë e domosdoshme ruajtja e ekuilibrave në momente të vështira. Sidomos në jug të Shqipërisë ku jeton një minoritet që nuk është një shoqëri e mbyllur. Për mua ekzistojnë mundësi për përplasje të tjera përderisa qeveritë do të jenë pre e poltikave dhe alcancave të diktuara. Megjithatë, asnjë përplasje nuk mund të kapërcejë dëshirën e mirë të dy popujve për bashkëjetesë në paqe.

"Dita": Cili do të jetë ndikimi i lirimit me kusht në veprimtaritë e ardhshme të OMONIA-s?

P.Barka: Në fillim të pergjigjes do të shtroja një pyetje: A do të kthehen të pestë në udhëheqjen e OMONIA-s? Për këtë qëndrim të tyre në këto momente të para asnjëri prej tyre nuk është shprehur dhe nga udhëheqësit aktual të OMONIA-s nuk ka ndonjë reagim. Megjithatë, liderët e kësaj organizate duhet të përfillin të gjitha mesazhet që morën gjatë kohës që veprimtarët e saj ishin në burg dhe mesazhet të qarta vijnë nga pjesëtarët e minoritetit që ajo përfaqëson. Edhe në rast rikthimi vetë të gjykuarit duhet të respektojnë mesazhet e popullit të minoritetit, pastaj të shkëputen nga çdo lloj ndikimi dhe mos u shërbejë burgu si shkak për një hakmarrje. Kur flas për një shkëputje nga çdo lloj ndikimi kam parasysh nga ndikime nacionaliste që vë në një rrezik të jashtëzakonshëm bashkëjetesën në paqe .

OMONIA dhe të pestë duhet të shkëputen nga ndikimet e qarqeve nacionaliste të cilat ekzistojnë në Shqipëri, Greqi apo Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Intervistoi: E SERJANI

OPINIONI

Ende kufizime për gjuhët e minoriteteve etnike

PANAJOT BARKA*

1. Këndvështrimi dhe pikat e referimit në trajtimin e problemit. Trajtimi i çështjes mbi të drejtat dhe përdorimin e gjuhës amëtare, si element bazë i evidentimit të identitetit të një minoriteti Etnik apo Kombëtar, presupozon një larmi këndesh vështrimi, ashtu si dhe pikash referimi. Pra janë të pranishme pyetje të tilla si, cili është niveli njohës dhe i përdorimit të gjuhës amtare nga vet anëtarët e këtij minoriteti dhe cilat janë kushtet e krijuara nga shteti për këtë qëllim. Cili është niveli i përdorimit të kësaj gjuhe në marrëdhëniet e individit, apo dhe të komunitetit të minoritetit etnik me strukturat e shtetit. Cila është klima e kultivuar për mënjanimin e konfliktualitetit, që shkakton kjo e drejtë me shtresat e ndryshme të shoqërisë që përbën shumicën. Sa dhe si ndikon klima e kultivuar në të kaluarën. Cili është raporti i gjuhës amtare dhe asaj zyrtare tek anëtarët e minoritetit etj. Në varësi të kësaj problematike ekzistojnë në vijim pikat e ndryshme të referimit. E gjithë kjo gamë problemesh lidhen me një qëllim final: njohja dhe përdorimi i gjuhës amtare, ashtu si ruajtja dhe zhvillimi i identitetit kombëtar në logjikën integruese të minoritetit në shoqërinë shqiptare, pa reagime nacionaliste ose ksenofobie apo tendenca asimiluese nga ana e shumicës. Në këtë kuadër përsa i përket minoritetit etnik grek, duke marrë si pikë referimi të kaluarën komuniste apo dhe vitet e para post komuniste konstatohen lehtë ndryshime pozitive në shumë drejtime, të cilat ruajnë njëkohësisht një tendencë vijueshmërie pozitive në të ardhmen. Duke marrë si pikë referimi nivelin e kërkuar, të shprehur dhe në Konventën Kuadër për Mbrojtjen e të Drejtave të Pakicave Kombëtare ekzistojnë akoma probleme, që lidhen me krijimin e klimës së përshtatshme shoqërore të respektimit të identitetit gjuhësor dhe me mungesën e legjislacionit përkatës. Në literaturën sociolinguistike, përdorimi i gjuhës amtare nga pjesëtarët e minoritetit etnik krijon realitetin e dygjuhësisë gjeopolitike për arsye të jetesës të kësaj bashkësie etnike, me të drejta të njohura të barabarta me komunitetin e shumicës në një hapësirë të njëjtë shtetërore. Madje një situatë e tillë konsiderohet shpesh me premisa konfliktuale si në aspektin linguistik, brenda komunitetit etnik ashtu dhe në aspekte sociale e politike. Kjo varet në mënyrë determinante nga mënyra si vepron ndaj këtij komuniteti apo dhe individëve të tij, faktori institucional i një vendi dhe faktori shoqëror i tij. Varet nga politikat integruese apo asimiluese që mund të ndiqen nga faktori i shumicës ashtu si dhe nga predispozitat integruese apo vetizoluese të vet komunitetit të minoritetit etnik. Shmangia e këtyre premisave konfliktualiteti pranohet dhe përbën një epërsi kulturore të të dy palëve me përfitim reciprok. E kundërta mbart situata me pasoja të rënda të cilat shpejt a vonë reflektohen.

2. Mentaliteti i trashëguar për të drejtën gjuhësore. Le të mos harrojmë që gjatë 50 vjetëve të sundimit të shtetit totalitar komuniteti i minoritetit grek në Shqipëri përjetonte një konflikt të brendshëm të pashpallur në statusin e tij dygjuhësor. Së pari politika izoluese e ndjekur nga shteti komunist dhe shpallja në këtë kontekst armik të Shqipërisë, Greqinë shtetin am të anëtarëve të Minoritetit grek, përcillte te kjo popullsi ngarkesa negative dhe boshllëqe të theksuara në ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kulturor gjuhësor. Po ashtu, nevoja për të ruajtur identitetin e vet e bënte atë shumë të kujdesshme në evidentimin e etnisë së tij. Madje pranonte imponimin që i bëhej nga shteti totalitar drejt ruajtjes së trajtave formale etnike sa për konsum propagandistik nga njëra anë dhe ideologjisë komuniste të krijimit të njeriut të ri hibrid komunist, pa fe, pa tradita, pa identitet. Ky fenomen i imponimit të gjuhës zyrtare u zhvillua më dukshëm në të gjitha rastet në mënyrë masive apo individuale, jashtë zonave me popullsi kompakte të etnisë greke akoma dhe në familje me martesa të kryqëzuara. Pra në kushtet e nevojës për ruajtjen formale të identitetit etnik dhe të imponimit zyrtar zhvillohej klima e autoçensurës deri në atë shkallë, sa që anëtarët e minoritetit etnik grek në Shqipëri pranonin të thirreshin thjesht minoritarë. Përdorimi i emrit grek ishte sinonim i fjalës armik madje dhe objekt i veprimit të kodit penal. U krijua kështu një status i veçantë identiteti minoritar, në vend të identitetit etnik grek.

3. Pasojat dhe në mentalitetin e sotëm. E keqja është se mentalitete të kësaj praktike vazhdojnë të vegjetojnë dhe sot. Ky mentalitet shprehet kryesisht në formën e nacionalizmit të tipit komunist, frikë asimilimi të shumicës nga pakica dhe ka si pikë referimi nivelin e të drejtave të lejuara nga sistemi totalitar, si më pa parrezikshme për komunitetin e shumicës. Kështu predispozicioni pozitiv i strukturave shtetërore për t'u përgjigjur standarteve ndërkombëtare apo dhe angazhimeve konkrete me aktet ndërkombëtar, has shpesh në presionin e këtij mentaliteti që arrin dhe nivelet e mediave apo dhe individëve të veshur me pushtet. Po përmend një shembull. Në një klasë të një prej shkollave 8-vjeçare në qytetin e Gjirokastrës me 35 nxënës, 7 prej tyre janë me origjinë greke. Mirëpo ata kurrë nuk komunikojnë midis tyre në gjuhën amtare. Madje kërkojnë nga prindërit dhe të afërmit që në prani të shokëve të tjerë të klasës, të mos u flasin në gjuhën amtare. Kur e pyetën njërin prej tyre pse druhet, ai u përgjigj se nuk dua të më shajnë me fjalën grek. Kjo klimë bëhet fjalë për ato qendra të banuara me popullsi të përzier apo ka anëtarët e minoritetit etnik grek janë në minorancë është e vërtetë, se nuk vihet re në mënyrë aq të theksuar në nivele më të larta arsimore apo dhe në mosha më të rritura në marrëdhëniet tregtare e ekonomike, pavarësisht nga problemet apo episode sporadike konfliktuale. Po ashtu duhet thënë se një pjesë e minoritarëve kryesisht ku gjuha amtare është zotëruese e moshave të mesme, ndiejnë se duke huazuar mentalitetin e vjetër komunist, pra duke fshehur pjesën më të dukshme të identitetit kombëtar, gjuhën apo dhe elementë të tjerë mund të përfshihen më mirë në jetën social-politike të vendit apo dhe të përfitojnë për vete më shumë. Fakt është që shumica nga anëtarët e minoritetit grek në struktura të ndryshme shtetërore e zotërojnë gjuhën amtare poshtë nivelit mesatar. Ky grupim përbën atë pjesë të anëtarëve të minoritetit etnik grek që pretendon se ky minoritet i ka të gjitha të drejtat edhe gjuhësore ose nuk interesohet për to. Përballë tyre ngrihet kategoria tjetër që shpesh për përfitim politik pretendon se na mohohen të gjitha të drejtat. Fakti është se komunikimi i lirshëm me shtetin am në 10 vitet e fundit pas një mohimi totalitar 50 vjeçar si dhe epërsia ekonomike e Greqisë ndaj Shqipërisë, krijoi lidhje të reja dhe të forta deri në një tendencë të kthimit të krahëve të shoqërisë shqiptare ashtu siç është fakt, që greqishtja duke u nisur nga roli i Greqisë në jetën tregtare në rajon pranohet pa asnjë paragjykim, madje përdoret dhe nga pjesëtarë të shumicës shqiptare. Në këto kushte në minoritetin etnik grek në Shqipëri kemi një ekulibër të ri gjuhësor. Ekziston një brez i ri, tek i cili përdorimi i gjuhës amtare është perfekte dhe shumë autoritare ndaj gjuhës zyrtare. Kemi një brez të mesëm, i cili në rast se nuk ka zhvilluar kontakte të ngushta me shtetin am, është inferiore ose në pozita të barabarta ndaj gjuhës zyrtare dhe një brez të tretë, që i përket moshës së tretë.

*Panajot Barka
Pedagog
në Universitetin
e Gjirokatrës
Kryetar i
shoqatës "Afirmuesit
e identitetit tonë"

DITA
BOTIM I "DITA GROUP" SH.A
KRYEREDAKTOR HENRI ÇILI KRONIKA ZYLYFTAR BREGU
KULTURA IVA TIÇO
SOCIALE ELDA SPAHO
RR. "GJ. FISHTA" TEL&FAX: 244 509, 334 11 gazetadita@mail.com

Panorama
Botim i PANORAMA GROUP

Nga Panajot Barka

Ngerç elektorial apo ngerçi i demokracisë?

01.01.2007/10/01/2007

Politika, si aspekti më i rendësishëm i jetës në vend, e mbylli 2006-ën duke lenë në fuqi krizën me të rendë elektorale në vend. Në plan të parë ajo duket thjeshtë teknike, ose e stimuluar nga kapriçio përsonale apo të grupit. Në fakt është me e thellë. Ajo i kapërcen kufijtë e frikës së një fitoreje të manipuluar dhe prek drejtpërdrejt konceptin e demokracisë, në të cilën respekti për parimin e votës së lirë e lidhet me funksionin jetik për të, atë të rolit të pozitës dhe të opozitës.

Në këto rrethana, thelbin e krizës politike të zgjedhjeve të tanishme lokale në vend mund ta kuptojmë vetëm duke përqasur situatën e tanishme politike me atë të zgjedhjeve lokale të verës së vitit 1992. Të dy këto momente konfigurojnë në mënyrë diakronike mentalitetin politik të lidershipit të sotëm dhe të atëhershëm në mazhorancë për të drejtuar vendin pa opozitë, ose me një opozitë të dobësuar deri të nxjerrë jashtë loje politike.

Zgjedhjet e atëhershme lokale u zhvilluan kur në pushtet prej disa muajsh ishte mazhoranca e tanishme. Ato u shoqëruan me burgosjen politike të liderit të opozitës së atëhershme Fatos Nano. U akuzua thjeshtë për korrupsion. Synimi qe i qartë. Opozita e atëhershme që mbarte mbi supe peshën e rendë të trashëgimisë komuniste, duke pasur në burg liderin e vet, të trembej dhe të shpartallohej totalisht. Në fakt ndodhi e kundërta. Tani ndodhemi serish në të njëjtën situatë. Pozita e sotme e mbeshtetur ose e varur totalisht te i njëjti lidership politik, është në pushtet prej një viti e disa muaj. Brenda kësaj periudhe po vertetohet se ajo nuk tërhiqet nga përpjekjet për të kontrolluar institucionet e pavarura të shtetit dhe për të pasur një opozitë inegzistente. Përsa i përket dobësimit të opozitës, mazhorancës do t'i mjaftonte konseguenca praktike e parullës politike elektorale:- lufta kundër korrupsionit të opozitës dje në qeveri. Mirëpo provat treguan se kjo luftë e bashkoi më fortë opozitën, (edhe pse shpesh për të mbrojtur interesat përsonale) dhe e bëri me të ashpër luftën ndaj qeverisjës së liderit të mazhorancës së sotme. Nga ana tjetër, mazhoranaca duket se e kuptoi që konseguenca për një kohë të gjatë në këtë luftë do t'i hiqte realisht asaj mundësinë për të përfituar përsonalisht me të njëjtën mënyrë. Në këto rrethana lideri politik i mazhorancës, duke u nisur nga mënyra e vet e drejtimit, (duke përqendruar në mënyrë absolute në dorën e tij të gjitha kopetencat), shikon si mundësi të vetme dobësimi të opozitës nxjerrjen jashtë loje të liderit të saj E.Rama. Rast më të mirë nuk ka se sa humbja e drejtpërdrejtë e tij në rikadidimin për në krye të bashkisë së kryeqytetit.

Përveç kësaj lideri i mazhornacës, Berisha, ka edhe disa arsye të tjera për ta kthyer këtë betejë elektorale në qëllimin më të lartë politikë të tij. Lideri i sotëm i opozitës, në kuadrin kohor që e drejton atë, ndonëse nuk arriti ta sherojë partinë e tij nga semundjet e renda, pasojë e abuzimit me pushtetin politik të qeverisjës, pati merita në planin anti-Berishë. Arriti ta frenojë ose ta kthejë mbrapshtë atë, pothuajse në të gjitha inkursionet politike në dem të opozitës dhe kontrollit të strukturave të pavarura të shtetit. Ndryshe, pra nga raporti Berisha – Nano ku palet ishin reciprokisht komplementarë, ku Nano i

lëshonte Berishës pjesë nga pushteti i tij i pafund i siguruar pas trazirave të 1997, raporti Rama - Berisha ka në thelb antiberishizmin, në emer të ruajtjës së standarteve në drejtimin e shtetit.
Një humbje e Ramës në luftën për kreun e bashkisë së Tiranës, do të thotë të lëkundet deri në palcë autoriteti i tij në krye të opozitës, autoritet ende i pakonsoliduar dhe me brerje të brendshme serioze. Pra, opozita do t'i rihynte procesit të njohur për rigjetjen "e liderit të padiskutueshëm", fakt që do ta fuste në një rreth vicioz të pafundëm. Drejt këtij synimi Berisha ka me siguri mbeshtetjen e heshtur të faktorit opozitë brenda opozitës, i cili ose ka renë nga fiku, ose ka synime të hapura për të marrë drejtimin e opozitës, ose të posteve të larta shtetërore të cilat arrihen vetëm me ndihmën e Berishës. Zvogëlon gjithashtu premisat lidhur me tezën e hedhur se pas Nanos i vjen radha Berishës për të dalë në pension politik.
Kjo, jo vetëm do ta shpetonte Berishën nga frika e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, aq të përfoluara dhe aq të mundshme, por do t'i siguronte atij zgjatjen e mandatit qeverisës dhe mbi të gjitha një liri të pakontrolluar në drejtimin e vendit dhe të shtetit. Vetëm kështu mund të kuptohet "lufta" e shpallur për marrjen e drejtimit të kryeqytetit.
Berisha e deklaroi i pari dhe që në fillim këtë qëllim. Betejën për Tiranën e shpalli si humbje të domosdoshme të kryetarit të opozitës. E lidhi krizën "vetëm me një njëri" dhe "ky quhet Edvin Rama". E thjeshtoi problemin me nëvojën e këtij të fundit për të "fshehur korrupsionin dhe lidhjet me bandat kriminale".
Por, problemi nuk është aspak kështu. As nuk lidhet thjesht me terrorin verbal të liderit të mazhorancës kundër kundërshtarit politik. As me faktin se Rama ka nga mbrapa një vepër të admirueshme në krye të punëve në kryeqytet që tremb çdo kundërshtar në ballafaqimin me të. Problemi lidhet me shumë me imazhin që krijohet për foshnjërinë e demokracisë në vend që buron nga koncepti i mazhorancës për të drejtuar pa kundërshtarë.
Edvin Rama është lideri i opozitës dhe jo thjeshtë një kryetar bashkie apo një figurë tjetër e çfarëdoshme. Përderisa ai, si lidër i opozitës pranoi sfidën për të pretenduar qëverisjën e bashkisë së Tiranës, mazhoranca duhej të kafshonte buzën dhe në respekt të opozitës të pranonte edhe ajo sfidën. E kundërta është moralisht e denueshme. Në asnjë vend të botës nuk ndodh që një forcë politike, aq me pak mazhornaca, të grumbullojë të gjitha forcat e mundshme, të ligjshme dhe të paligjshme, të ndërshme dhe të pandërshme, me qellim që të mund kryetarin e forcës politike kundërshtare, aq me keq kryetarin e opozitës. Përkundrazi, si pozita dhe opozita, atje ku kandidojnë lideret apo dhe figura të tjera të spiktura të secilës forcë, u krijojnë konstruktivitetin e duhur për t'u zgjedhur. E kundërta mund të ndodh atëherë kur janë të domosdoshme premisa për përmbysje të sistemit politik. Në vendin tonë i kemi të dyja rastet. Në zgjedhjet e para pluraliste në vend, më 31 mars të vitit 1991, Ramiz Alia, numri një i shtetit komunist në vend, "humbi" betejën përsonale elektorale. (!!) Ai e pranoi sfiden se ishte i ndërgjegjshëm se "humbjen" e tij e kërkonte situata politike. Ishte një sinjal se komunizmi e pranoi fundin e tij me një rrugë politike pa shumë gjak. Në zgjedhjet e Korrikut 2005 mazhoranaca e atëhershme i vuri kryetarit të opozitës në Kavajë një kundërshtar, (pa dashur ta fyej) honorifik, për t'i krijuar atij terrenin e duhur për të udhëhequr fushatën elektorale të gjithë opozitës. (Fakt është se opozita e para trekorrikut nuk bëri plotësisht të njëjtën gjë me kryetarin e mazhorancës së atëhershme në zonën e Sarandës)
E keqja tjetër lidhet me faktin se qëllimin politik më të lartë, sipas gjykimit të mazhorancës, ajo kërkon ta arrijë me çdo kusht e mjet dhe duket se për këtë ka kohë që punon. Nga ana e vet edhe opozita e ka kuptuar lojën e lëxueshme të mazhorancës.

Rezistenca e saj në kërkim të standartëve diktohet më shumë nga përvoja se po ndodhi e keqja askush nuk do të mund ta korrigjojë. Vërrejtjet e ndërkombëtarëve nuk do të kenë vlerë për pasojat e çdo rezultati të manipuluar në jetën e brendshme politike të partive dhe të gjithë vendit. Eshtë pikërishtë kjo përvojë që e mban opozitën të bashkuar. Por dhe thelbi i krizës elektorale që mban faktorin ndërkombëtar tëpër të kujdesshëm në këmbënguljen e tij për arritjen e standartëve.
Në këtë kuptim defektet ligjore në rregullimin e infrastrukturës zgjedhore, këmbëngulja e opozitës për arritjen e standarteve dhe respektimin praktik të tyre, nuk mund të lidhen thjesht me interesa politike të çastit. As me pamundësinë tonë për të realizuar zgjedhje sipas standarteve evropiane, ose si çdo vend tjetër i parafundit të Ballkanit dhe të Evropës. Lidhen, siç e thamë edhe në fillim, me konceptin e mazhorancës tonë për demokracinë dhe rolin e opozitës në të.

Panajot Barka, për gazetën "SHQIP" data 29.12.2006 (Bl. Zaganjori me dat.05.01.2007 ktheu përgjigje negative nëpërmjet sekretares se nuk e boton dhe unë nuk do të kem të drejtë të botojë me shkrime aty. Shkrimin e dergova tek Panorma nëpërmjet I. Babaramos. Të shohim

U botua me 10.01.2007. eshte e arshivuar

Nga prof.asoc. Panajot Barka 07.02.2021

Angazhimi i mangët intelektual në lidhje me marrëdhëniet greko-shqiptare në Epir shtrëmbërojnë historinë dhe vrasin të ardhmën.

https://www.gazetatema.net/2021/02/08/civilizimi-nuk-perben-kurre-rrezik-asimilimi/

E konsiderova detyrim ndaj vetës dhe lëxuesve tuaj të ndërhyj në raport me dabatin e hapur në revistën tuaj lidhur me raportin dhe marrëdhëniet greko-shqiptare, sidomos në Epir, që mori shkas nga një emision televeziv mbi identitetin etnik të Dropulliteve.

Së pari, duke u nisur nga fakti se nga autorë të ndryshëm në këtë debat u abuzua me emrin tim për shkrime me pseudonim, dua të theksoj se kjo bie ndesh me natyrën dhe integritetin tim dhe konkluzionet e kësaj natyre janë abuzive, ose nisen nga vetja e atyreve që konkludojnë kështu. Në medjat shqiptare, të shkruara apo eleketronike kam mbi 600 shkrime të natyrave të ndryshme dhe që të gjitha mbajnë vetëm emrin tim, pavarësisht nga problematika dhe pasojat e mundshme. (Me këtë rast vlerësoj dhe falenderoj të gjitha ata që bashkëpunuan me mua në këtë drejtim)

Së dyti. Pa dashur të bëjë unë konkluzionet, mendoj se debati, pavarësisht nga titujt akademikë dhe referencat e protagonisteve, i kundërvihet, deri në antagonizma të njëanshme me synime për ndryshim raportesh, apo dhe eliminim realitesh, të lidhuira me relaitetin e vërtet historik dhe diakronik të Epirit. Bëhet fjalë për një njësi gjeografike me kontribute fontamentale paraprirëse e vijuese në kulturën greke, e cila i dha dritën horizontet kulturës dhe civilizimit botëror. Bëhet fjalë për një trevë që ruan diakronikisht natyrën specifike të këtij civilizimi, atë të bashkëjetesës, të multikulturës, unitetit dhe të të kundërtave, të tolerancës, të humanizmit, si mundësi që promovon dhe zhvillon konsistencë, identitet të veçantë, një trashëgimi kulturore mbështetur mbi raportët e njeriut të këtueshëm me natyrën dhe raportët e tij me vetën dhe botën. Në natyrën e vet civilizuese, kjo kulturë nuk interesohet për bartësit si të tillë por për produktin e vet (veti që dallon akoma edhe sot "perandorinë" e Aleksandrit të Madh me origjinë po nga Epiri, nga të gjitha llojet e perandorive që u përpoqen ta imitonin apo dhe nga vet globalizmi i sotëm)

Shikoni, akoma edhe sot në Epir (si unitet dhe pavarësisht kufijve politikë, Epir i Veriut apo i Jugut) mënyra e organizimit të strukturave shoqërore tradicionale, pavarësisht nga identiti etnik, mbështet në traditën e orakullit të Dodonës. Ka në qendër një pemë, në krahë objektet e kultit, institcionet e tjera të kulturës apo të administratës dhe në vijim, kryesisht në formë gjysëm rrethore, janë banesat.Vërtetohet se që nga koha e formësimit të orakullit ka zanafillën edhe kënga polifonike etj.

Së treti. Debati, si i tillë dhe pjesëmarrja në të dhe i zërave të tjerë përveç monopolisteve abuzues, provoi tronditjen që pesoi establishmenti i ideologjisë nacionaliste i kultivuar që në kohën e rrënies së Perandorisë Otomane dhe kristalizuar nga sistemi komunist, që ka të bëjë me rimarrjen dhe evidentimin e armiqve të Perandorisë Otomane për të përcaktuar dhe për të evidentuar më mirë identitetin tonë; për të paraqitur cilësinë më domëthenëse të helenizmit, që është civilizimi, si bashkëjetësë, multikulturë, unitet të kundërtash etj, si rrezik asimilimi. Dhe për këtë tentohet kompensimi (por vetëm për konsum të brendshëm) me përvetësim të kulturës

së tjetrit deri në mohim vlerash unikale, në nivle të tilla që një ballafaqim sado i thjeshtë me bibliografinë dhe mendimin ndërkombëtar do të na klasifikonte qesharakë!)

Në këtë frymë, në debat u perserit p.sh argumenti për "frymën nacionaliste" të bibilografisë greke, ndërkohë, që edhe ato pak dokumenta që serviren në favor të shqiptarizmit rrjedhin nga bibliografia helene.

Së katërti. Në këtë kontekst, u përdor një taktikë më e kohës për të dalë te një rezultat sigurisht më të rrezikshme se sa deklamimet e hapura nacionaliste me argumente propagandistike. Kjo për faktin se dokumente të veçanta dhe të shkeputura nga realiteti (dhe me burim grek) u fetishizuan. Ose, në debat, në emër të të qenit i pranueshëm nga audjenca shqiptare të cilës i drejtohen dhe duke abuzuar me titullin shkencor u thanë disa gjysëm të vërteta që janë më të rrezikshme se mashtrimet. U bënë lëshime të tilla shkencore e bibliografike që jo vetëm shtrembërojnë realitetin historik, por venë në dyshim dhe të ardhmën. P.sh, për konfortabilitetin "e palëve", këta studjues u heqin banorëve të Epirit, helenëve, vazhdimësinë që nga lashtësia dhe i spostojnë fillesat e tyre në Epir në kohën e Mesjetës kur evidentohet dhe prania e elementit alban. Ndërkohë, hedhin posht pretendimet se grekët e sotëm janë të ardhur në trojet e tyre shumë vonë, aty nga shekulli XVIII, si çifiçinj të varfër dhe pa kulturë të cilën ua huazuan vendasit shqiptarë, të cilët fatkeqësisht u asimiluan prej ardhësve !! Ndërkohë u shtua terminologjia me konatacion negativ ndaj grekëve, ose me marifete nuk dilet në asnjë konkluzion, për oarigjinë e së cilës palë dhe hidhet me shumë mjegull si ushqime i qarqeve nacionalistë me nivel kulturor të ulët dhe pa mundësi gjykimi e vlerësimi.

Së pesti. U vu re gjithashtu një fakt me remineshenca dyfishttë demshme. Në emër të parimeve të drejta shkencore u kërkua në debat një qasje adekuate. P.sh, është e vërtetë se duhet të evidentohen dhe të konsumohen burime të ndryshme informacioni. Realisht, institucionet zyrtare me integritet dhe përgjegjësi shkencore në vend nuk promovojnë burime të ndryshme për këtë problem, por nuk dalin as vetë në konkluzione përkatese (veçse konsumojnë përtzpjet e sistemit komunist). Për pasojë, përpjekjet individuale derivojnë shpesh në dorë të kaosit dhe abuzimit, apo destruktivitetit akademik. Nga ana tjetër, ky mendim shkencor gjithmon e më shumë tenton vetëm opinionin publik shqiptar dhe me motiv përgjithësisht atë nacionalist. Mendoj gjithashtu se kjo kërkesë mbëtet inefiçente për opinionin publik shqiptar, në kushtet kur ai, ashtu si edhe vet mendimi shkencor, ka renë pre i sundimit e emocionit nacionalist i shfaqur si antihelenizëm. Këtë realitet nuk e justifikon as heshtja e palës greke, që vjen kryesisht për shkak të nënvleftësimit të argumentit shkencor shqiptar. Këtë realitet, mungesën e ballafaqimit të mendimit shkencor shqiptar, qoftë me atë të fqinjit apo dhe me atë evropian dhe botëror, si shprehje e mangësisë së objektivitetit shkencor, e kanë venë re shumë institucione shkencore perendimore, me në krye akademikët austriakë dhe gjermanë. Pra, në kushtet kur të paktën ka një mungësë serioziteti shkencor dhe një ekspasion nacionalist të rendit ideologjik si edhe nëse vërtet duam të vërtetën dhe prosperitetin që na servir historia e gjatë dhe e përbashkët, duhet të organizohen ballafaqime të vërteta shkencore dypaleshe dhe globale, ashtu siç bëri me 2016 Akademia e Shkencave për Voskopojën.

Së gjashti. Me këtë qasje lidhet edhe fakti tjetër. Në argumentin teorik të debatit u përdor shpesh një fakt i vetëm, i shkëputur nga mjedisi historiko-kulturor që e prodhoi, aq më tëpër kur dihet se një fakt i vetëm nuk mund të përgjithësohet dhe të shërbejë për rezultate shkencore shtëruese. Apo, me keq ta përdoresh atë për të justifikuar politika dhe qëndrime të ndryshme.

P.sh. Në debat u kthye në strumbullar prove në favor të argumentit të pranisë së elementit shqipfolës në trevat e komunitetit të sotëm të minoritetit etnik grek, një

dokument e vitit 1856 që lidhet me një përgjigje pozitive të Patriarkanës së Konstandinopojës ndaj kërkesës së një komuniteti shqipfolës që nuk ka lidhje me elementin helen ortodoks në jugun e sotëm të Shqipërisë. Madje, hidhet dhe teza se kjo përgjigje ashtu si edhe ajo ndaj Mihal Gramenos me 1909, ishin produkt i presionit politik të P. Otomane në favor të elementit shqiptar.

Intërpretimi i faktit apo i fakteve në fjalë nuk i përgjigjen realitetit, ose është së paku i njëanshëm. Dihet se interesi i Perendimit për krijimin e komb-shteteve në pjesën evropiane të P. Otomane, pas revolucionit grek të 1821) kishte si premisë kryesore identitetin e tyre të krishterë. Pionieri i këtij interesimi për shqiptarët me shumicë myslimane ishte *British and Foreign Bible Society* e cila që në dhjetëvjeçarin e tretë të sh. XIX i kërkoi lejën e Patriarkanës për përkthimin e librave të shënjta në gjuhën shqipe. Patriarkana, nisur nga parimi i Bizantit, "një fe shumë gjuhë" dha pëlqimin e kësaj inisiative. Qëllimi ishte i qartë. Në aspektin fetar shikohej mundësia e rikrishtërimit të elementit të myslimanizuar shqiptar dhe së dyti, në kuadrin e idesë së hedhur nga Kollokotroni me 1823, i cili, duke u nisur nga pesha e madhe e shqiptarëve në krah të P.Otomane, synoi një alenancë të mundshme me ta duke propozuar një shtet dualist Greko-shqiptar. Në këtë kuadër personalitete të kohës së shqiptarësisë, si Veqilharxhi, Meksi, Argjirokastriti, të cilët ishin dhe anëtarë të Philiqi Etairias (krahu politik dhe ushtarak i revolucionit grek), u angzhuan në këtë proces, që u kulmua me kërkesën zyrtare të Gjolekës, ndaj mbretit të Greqisë për çlirimin e Epirit nga pushtuesit otoman dhe bashkimin e tij me Greqinë, mjaft që të respketohej gjuha dhe besimi.

Në këtë logjikë me 22 prill 1845, Veqilharxhi mori një letër nga sekratari i Mitropolisë së Korçës ku i transmetonte qëndrimin pozitiv të Mitropolitit për abetarën e tij.

Në këtë klimë helenizmi dhe ideologjia e re greke, sh. XVIII-XIX shërbeu si shtrat për ideologjinë kombëtare shqiptare, që sipas balkanologës N. Clayer, nisi si pjesë e helenizmit dhe vijoi e lidhur ngusht me të, ndaç si komplementare, ndaç si kundërshtare. Literatura greke dhe mjedisi grek u bë për më shumë se gjysëm shekulli (1860-1905) mjeti për promovimin e problemit shqiptar. Gjithë plejada i rilindasve shqiptarë, ortodoksë apo myslimanë, njihnin greqishtë, shkruan dhe botuan greqisht.

Eshtë e vërtetë se me reformat e Tanzimatit dhe veçanërisht me ardhjen e xhonturqve interesi i P. Lartë për elementin shqiptar ishte i madh dhe lidhet me nëvojën e saj për të patur aleanca të qëndrueshme këtu, pasi, pas Krizës së Lindjës, fundi i saj këtu ishte i dukshëm. Këtij qëllimi i shërbëu edhe zëvendësimi në analet zyrtare të Perandorisë me 1892 të etnonimit "arnaut" me etnonimin "albanët- shqiptarët" dhe prodhomi i një serë dokumentash të natyrave të ndryshme për të provuar indentitetin shqiptar, sidomos në Epir. Për herë të parë P. Otomane kujtohet të hap shkolla në gjuhën turke për të konkuruar shkollat greke, (si në rastin e Janinës) dhe jep leje për legalizimin e veprimtarive në gjuhën shqipe.

Po ashtu dihet se konfodimi i interesave të fuqive adriatike me ato të P. Otomane në fillim të shek XX, bëri që komuniteti shqiptar t'i kundërvihet helenizmit me objekt kryesisht fenë ortodokse, fenomen që për defektet e vet kishës ortodokse dhe politikës së saj, u evidentua dhe në proceset e formimit të kombështeteve të tjera në Ballkan.

Solla këtë shëmbull, në kuadrin e gjithë ndërhyrjes time në dabat për të thenë se realiteti diakronik i natyrshëm i marrëdhënieve midis grekëve dhe shqiptarëve në këtë rajon identifikohet plotësisht me frymën evropiane sot dhe se politika dhe interesat e ndryshme ushqëjnë, sidomos në disa elementë dhe nivele të shoqërisë shqiptare, ndasinë, konfliktualitetin, gjuhën e urrejtjës! Besoj se impenjimi intelektual duhet t'i kundërvihet këtij lloj ushqimi.

Revista Pejsazhi i fjalës